

Syllabusi i lëndës

Lënda: KUR'AN III

Programi i studimit: Teologji Islame

Numri i ECTS kredive: 7

Statusi i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 301

Fondi i orëve: 3+2

Viti akademik: 2026-2027

Semestri: -V-

Mësimdhënësi: Dr. Hfz. Safet Hoxha

Qëllimi i lëndës

Qëllimi i lëndës është ti njohë studentët me leximin më të përafërt të Pejgamberit a. s. sipas rivajetit të Hafsit nga Asimi si dhe rivajetet tjera të leximit të Kuranit nga shtatë apo dhjetë kiraetet. Ti njoh studentet me specifikat e shkrimit të mus-hafve të othmanit, pacenushmërin e atij transkriptimi dhe zhvillimet e më vonshme që kanë qar deri te nevoja i vokalizimit dhe pikësimit të tij.

Rezultatet e pritura të nxënies:

- Të përvetsojë leximin e mëparshëm
- Të njihet me leximet tjera të Kuranit
- Të mesojnë dallimin kur ndëgjojnë leximet tjera
- Të njohë gjendjen e mëparshme të mus hafeve
- Të njihet më format përfundimtare të shkrimit të mus hafit

Metodologjia e mësimdhënies:

Mësimi do të zhvillohet përmes ligjeratave, këndimit nga profesori ,leximi nga studentët,leximi dhe kontrolli nga vetë studentët,ndëgjimi i kurrave profesonistë,stimulimi i studentëve në lexime të lira, seminareve etj...

Përmbajtja e lëndës:

Leksionet janë të bazuara në kapitujt si më poshtë,unë i ndjeki kapitujt nga librat në gjuhen arabe por studentet mund të bazohen në ligjeratat e mbajtura në klasë si dhe pjesërishtë nga litratura e përkthyer apo autoriale në disa punime të bëra nga vitet e kaluara

Java e parë: Kuptimi dhe lënda e studimit, si dhe metodat e studimit të lëndës së kiraetit. Përforsim të rregullave të texhvidit nga kapitujt e parë, përmes ndarjeve skematike, kapitulli i nuni sakinit dhe tenvinit, llojet e idgameve dhe vendnaljet e tingujve. Llojet e leximit, leximet e ndaluara-urrejtura, përmledhja e rregullave të zgjatimit dhe vakfit përmes skemave.

Literatura: (Haku tilaveti 5-17), (fq.233-237)

Java e dytë: Sexhdeja e tilavetit ,tekbiri në fund të Kuranit dhe duatë më të zgjedhura të hatmes. Metoda e mësimin nga Pejgamberi a.s., interesimi i sahabve dhe gjeneratave pas tyre për lexim të Kuranit. Qendrat e para me leximet e Kuranit

Literatura: (fq.147- 155), (fq.191 -209). It haf Fudali el Beshher fq. 39- 45]

Java e tretë: Hadithi;“ Unzilel Kuranu ala sebeati ahrufin“ dhe transmetimet tjera në librat e haditheve. Mendimet e dijetarve rreth kuptimit në, „shtat harfe“. Drejtimi i Shatibis dhe Ibn el Xhezeris në përbledhjen e kiraeteve,dallimi i leximit të Hafsit sipas këtyre dy përmledhejve te kiraeteve

Literatura: (Po aty fq.40- 41). (Fenu et-tertil fq.73-85 El itkan fi ulumil el Kuran,E –Sujuti). (Hirzul emanij fq.10 -21 Tibetu e nneshr fq.15- 30)

Java e katertë: Parimet e shkencës së kiraeteve,burimi, lënda,qëllimi.Kush është el kariu, el mukriu dhe rangjet e tij. Përmledheja e kiraeteve,autoret e pare si dhe librat më të dalluar në këtë shkencë deri më sot. Imamet e kiraeteve, transmetuesit e tyre ,çka kuptojmë me kiraet,rivajet dhe turk, cilat lexime dhe rivajete lexohen sot në botë.

Literatura: (It haf el Fudalai el Beshher fq67 -70), (po aty fq.33- 37). (It haf el Fudalai el Beshher fq70 -74)Haku tilaveti fq. 45- 48)

Java e pestë: Leximi i el fatihas me kiraete, çka kuptoj me fjalën fersh dhe usul në terminologjinë e librit të Shatibis.Hyrje në rregullat e përgjithshme për secilin imam dhe transmetues. Leximi i mimit të shumsit, haunit të damirit.Leximi i lamit para shkronjave sadun,dadun taun sipas Vershit.Leximi i shkronjave simbolike.

Literatura: (Hirzul emanj fq. 27 -30 Et-tejsir... 34- 37). [po aty fq.9-12 E- ddurretul mudijetu fq.22]

Java e gjashtë: Zgjatimi mutasil dhe munfasil sipas imameve dhe transmutuesve .E-nakeli dhe sekteja. Idgami sipas Ebu Amrit leximi i dy hemzeve të njehta në një fjalë si dhe dy hemze të ndryshme në një fjalë apo dy fjalë. Leximi i raunit sipas Vershit, imaleja, taklili, kuptimi i tyre dhe kush i lexon nga imamet dhe transmetuesit e tyre.

Literature: [Hirzul emanij fq.14-19]. (E-tejsir... fq.55 -59)

Java e shtatë: leximi i raunit sipas Vershit, imaleja, taklili, kuptimi i tyre dhe kush i lexon nga imamet dhe transmetuesit e tyre. Leximet sipas vërtetsisë;e- tevatur ,el-ahad ,e-shadh kuptimi sipas lëmis së kiraeteve dhe cilat kiraete hynë për çdo grup.

Literatura: (Po aty fq.55-61). (Ithaf Fudalai el Beshher fq.70 -73)

Java e tetë: Lexim me tertil-hader. Rregullat e përgjithshme të leximit në kiraetin e Imam Nafiut sipas rivajetit të Vershit dhe Kalunit. Rregullat e përgjithshme të leximit në kiraetin e Imam Ibni Kethirit sipas rivajetit të Kumbulit dhe E-Beziu

Literatura: www.islamweb.net, www.islamway.net

Java e nëntë: Rregullat e përgjithshme të leximit në kiraetin e Imam Ebu Amrit sipas rivajetit të Duriut dhe Susiut. Rregullat e përgjithshme të leximit në kiraetin e Imam Ibni Amirit sipas rivajetit të Hishamit dhe Ibni Dhekvanit. Rregullat e përgjithshme të leximit në kiraetet e Imamëve të Kufes dhe transmetuesve të tyre; Imam Asimi, Shube dhe Hafsi, Imam Hamze Halefi dhe Haladi, Imam Kisaiu Duriu Ebul Harithi.

Literatura: www.islamweb.net, www.islamway.net

Java e dhjetë: Rregullat e përgjithshme të leximit në kiraetet e tre Imamëve të leximit el ahad. Ebu Xhaferi, Jakubi dhe Halefi. Shkrimi i Kuranit-resmul kuran, definicioni, vlera, qëllimi dhe dobitë e tij. Shkrimi arab dhe lidhjet e tij me diskriptimin e mushafeve. Interesimi i Pejgamberit a.s. për të mësuar sahabet shkrim –lexim. Roli i Kufes dhe Basres në stilin e shkrimit arab. Lidhshmeritë e diskriptimit uthmanij me rregullat e shkrimit arab. Tubimi I Kuranit në kohën e Ebu Bekrit dhe Othmanit r.a. shkaqet që ndikuan në anulimin e mushafeve, metoda të cilën e përdoren sahabet për shkrimin e mushafeve. Ushtrim i leximit në rivajetin e Kalunit dhe Vershit.

Literatura: [Po aty]. (Resmul mus-haf ve dabtuhu, fq.9- 10, Haku tilaveti fq.358-360). [Po aty fq.11-18]

Java e njëmbdhjetë: Natyra e shkrimit të këtyre mushafeve mendimet e dijetarve rreth kësaj çështje, si ata u shkruan në një nga shtat mënyrat e leximeve dhe si janë të përfshira të gjitha kiraetet në to sipas leximit të fundit nga Pejgameri a.s.. Mënyra si janë të përfshira kiraetet nëpër mushafe, që ka dy lexime dhe është shënuar në një, që ka dy apo më shumë lexime është shënuar në njërin e që mund të lexohen edhe tjerat etj. Ushtrim i leximit në rivajetin e Kumbulit dhe E-Beziut.

Literatura: (Po aty ,fq.21-24). (Po aty, fq.27- 35, Haku tilaveti fq.394 -395)

Java e dymbdhjetë: Specifikat e shkrimit uthmanij përcaktimi i rregullave në hadhf, zijade fasl, vassel, dhe të shënuarit e hemzes me shembuj nga Kurani. Qëndrimet e dijetarve rreth specifikave të shkrimit si dhe mendimet e orientalistëve. Ushtrim i leximit në rivajetin e Duriut dhe Susiut.

Literatura: (Po aty, fq.37, Haku tilaveti fq.366-380). (po aty fq.41- 58)

Java e trembdhjetë: A është shkrimi uthmanij tevkifi i pandryshuar qëndrimet e dijetarve rreth kësaj çështje gjatë historisë. Vendimet akademike fikhije rreth shkrimit uthmanij, mendimet e dijetarve dhe argumentet e tyre. Ushtrim i leximit në rivajetin e Hishamit dhe Ibni Dhekvanit.

Literatura: (Po aty fq.63-78). [Po aty, fq.81-85]

Java e katërmbdhjetë: Mus hafet dhe shkrimi I tyre gjatë periudhes së emevive dhe abasive. Mus hafet dhe shkrimi I tyre gjatë periudhes fatimijve,dhe usmanlijve. Ushtrim i leximit në rivajetet e leximeve të Kufes;Shubes,Halefet ,Haladit,Ebul Harithit dhe Duriut.

Literature: [fq.10-100]

Java e pesëmbdhjetë: Mushafet në kohen bashkëkohore dhe shtypshkronjat më të njohura të mus hafit. Ushtrime të leximit përmendësh. Përmyllje i planprogramit.

Kriteriumi dhe komponentet e vlerësimit:

Prezantimi dhe aktiviteti gjatë orës: 10 pikë

Punimi seminarik: 10 pikë

Vlerësimi i testit të parë: 40 pikë

Vlerësimi i testit të dytë: 40 pikë

Provimi final: me gojë

Standardi i notimit në FSI:

10= 90% - 100%. SHKËLQYESHËM- njohuri të shkëlq. me vetëm disa gabime minore.

9= 81 – 89. SHUMË MIRË – mbi mesatare standarde, por me disa gabime.

8=71 – 80. MIRË – rezultat në përgjithësi i mire me disa gabime që vërehen.

7=61 – 70. KËNAQSHËM – mire,por me mjaft gabime.

6=51 – 60. MJAFTON – rezultatet plotësojnë kriteret minimale.

5=0 – 50. DOBËT – kërkohet shumë punë për të fituar kredi.

Literatura obliguese:

1. Hirzul emanij ve vexhhu tehanij, Ahmed e Shatibij
2. Ithaf Fudalai el Beshar,Ahmed bin Muhamed Bena
3. Resmul mus haf ve dabtuhu,Dr.Shaban Muhamed Ismail
4. Et-Tejsir fil kiraati e-Sebea,Ebu Amer e Danij
5. Haku e-tilaveti,Husni Shejh Uthman

Literature jo obligative:

- 1En-Nesher fil kira-ati el Ashr,Muhamed bin el Xhezeri
- 2.El Itkan fi ulumil el Kuran,E –Sujuti
- 3.El Buduru ez-zahira fil kiraati el ashira, Abdu el Fetah el Kadi

- 4.El Burhan fi ulumi el Kuran,E- Zerkeshi
- 5.Dr.Qazim Qazimi,Njohuri mbi Kuarnin,Prishtnë 2006
- 6.Enes Kariq,Hyre në Shkencat e Tefsirit
7. www.islamweb.net, www.islamway.net

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studenti është i obliguar për vijimin e rregullt të ligjëratave dhe ushtrimeve (mbahet evidenca për studentët e rregullt). Të gjithë studentët janë të obliguar t'i përfillin rregullat e mirësjelljes: mbajtja e qetësisë gjatë mësimit, ç'kyçja e telefonave celular, dhe hyrja me kohë në sallë.

Konsultimet:

Orët e konsultimeve mbahen në kabinet sipas orarit të dhënë dhe mund të shfrytëzohet për ndihmë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me lëndën.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë\Javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike	2	15	30
Punë praktike	-	-	-
Kontaktime me mësimdhënësin\konsultime	1	15	15
Ushtrime në teren	1	3 ditë	3
Kollokfiume, seminare, ese	2	2	4
Detyra të shtëpisë	-	-	-
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim.	4	2	8
Koha e kaluar në vlerësim (teste, ese, provim final)	3	4 ditë	12

Totali	17	15 javë	132